



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Regjistrimi i Partisë: *Demokracia e Re e Kosovës - DRK*, i hapur për shqyrtim publik

**Prishtinë, 16 qershor 2009** – “Demokracia e Re e Kosovës” (DRK) sot ka kompletuar kërkesat për regjistrim, të parashtruara nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimi përfundimtar për regjistrim të iniciativës politike do të merret pas përfundimit të periudhës 7 ditore, gjatë të cilës publiku mund të shqyrtoj dokumentet e regjistrimit.

“DRK” është themeluar më 18 maj 2009 nga z. Gojart Lubeniqi dhe sipas programit të saj angazhohet për politikë ekonomike me orientim të bazuar në ekonomi të hapur, sundim të ligjit, për funksionimin e sistemit shëndetësor, sistemit arsimor, përkujdesje për të gjithë qytetarët e Kosovës, e rëndësi të veçantë do të kushtojë familjeve të dëshmorëve dhe veteranët e luftës, emancipimin e gruas dhe kushteve për shkollim dhe punësim të rinisë.

Zyrës për Regjistrim të Partive Politike i është dhënë përgjegjësia për regjistrimin e partive politike në Kosovë, nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Sipas Rregulles së KQZ-së nr.01/2008 për “Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë” *Secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë së bashku me çfardo të dhëne apo material që mbështet kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e kërkesës.*

Të gjitha materialet e regjistrimit duke përfshirë programin e partisë, statutin, dhe shenjën do të jenë në dispozicion për shikim dhe komente nga publiku.

Promovimi i transparencës për procesin e regjistrimit të partive politike është pjesë e procesit të KQZ-së.

Zyra për Regjistrim të Partive Politike gjendet në Rr. Agim Ramadani p.n në Prishtinë. Secili që dëshiron ti shikojë dokumentet mund të vijë në Zyrë prej orës 10-12 gjatë ditëve të rregullta të punës, nga data 16 qershor deri më 22 qershor 2009. Për informatë shtesë mund të kontaktoni Zyren për Regjistrim të Partive Politike / Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, +381 (0)38 20023004.